

Konferencë për media e OJQ-së Horizonti i Ri

Hulumtim i aktivistëve të rinj



Organizata e shoqërisë civile "Horizonti i Ri" publikoi të martën rezultatet e hulumtimit të problemeve dhe nevojave të të rinjve në komunën e Ulqinit, të realizuar në periudhën qershor – gusht të këtij viti. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ishte grumbullimi i informacionit për problemet aktuale dhe nevojat e të rinjve, në mënyrë që hartimi i dokumentit Plani i Veprimit për të rinj në komunën e Ulqinit, të jetë sa më cilësor.

Në konferencën e organizuar për medie, rezultatet e hulumtimit u prezantuan nga aktivistët rinor, të cilët punuan drejtpërsëdrejti në të

gjitha fazat e procesit të anketimit të të rinjve. Metodologjia me të cilën u zhvillua ky hulumtim, ishte ajo që "Horizonti i Ri" e zbaton tradicionalisht – anketimi në terren me anketues të trajnuar. Në këtë formë u realizua rreth 60% e procesit të anketimit të të rinjve. Përveç kësaj, të rinjtë kishin mundësi që pyetësorin t'a plotësojnë edhe në formë elektronike, në një nga platformat e internetit për hulumtime publike. Pyetësori ishte i hartuar nga dymbëdhjetë pyetje në të cilat janë përgjigjur 174 të rinj të moshës 15 – 29 vjeç. Hulumtimi ka përfshirë 9 fusha të interesit për të rinj: edukimi,

punësimi, shëndeti, pjesëmarrja e të rinjve në shoqëri, të drejtat e njeriut, koha e lire, kultura, familja, informimi dhe lëvizshmëria.

Ky hulumtim u realizua në kuadër të projektit: "POLITIKA PËR TË RINJ NË ULQIN", të cilin e mbështetë Fondi për qytetari vepruese (FAKT). Projekti zgjatë deri në fund të vitit dhe do të finalizohet me hartimin e plotë të Plani të Veprimit për të rinj dhe dërgimin e tij për miratim në Parlamentin lokal.

Për rezultatet konkrete të këtij hulumtimi, gazeta jonë do të informojë publikun në numrat vijues. **(kohapress)**